



## Konkurs arti

### Për kalendarin e PROGRES-it European për vitin 2017.

## Europa: Zgjedhje e duhur

### Përmbajtja

Në vitin 2016, PROGRES-i European tradicionalisht organizon gara për nxënës dhe nxënëse të shkollave të mesme nga juglindja dhe jugperëndimi i Serbisë me të cilat Programi bashkëpunon.<sup>1</sup>

Qëllimi i temës për këtë vit - „**Europa: Zgjedhja e duhur**” – është që të inkurajojë mendim dhe diskutim në mes të rinjve në Serbinë jugore me ato aspekte të anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin European (BE), nga të cilat mund t'iu sjellin dobi atyre personalisht, komunitetit lokal, por edhe shtetit në përgjithësi. Qëllimi kryesor është që të rinjve t'iu jepet mundësia që në mënyrë të pavarur të identifikojnë mundësitë për vete në rrugën drejt integritimeve në Bashkimin European, në atë mënyrë të bëhen të vetëdijshëm për rolin e tyre pjesëmarrës dhe aktiv në atë proces me ta edhe të identifikohen.

Këtë vit, konkursi përdor temën e publikimit ekzistues - „Ditari European” – doracak mësues për shkollat e mesme, qëllimi i të cilit është që në mënyrë kreative, të përshtatet me moshat të cilave u është dedikuar, i mundëson nxënësve të shkollave të mesme tema të rëndësishme në lidhje me bashkimin European dhe procesin e integritimeve europiane. Ditari Udhëheqës si element i garave për këtë vit, PROGRES-i European mundohet që të lehtësojë shkëmbimin e njohurive në lidhje me bashkimin European. Kapitujt e Ditarit, prej të cilit secili i korrespondon një temë të veçantë në lidhje me BE, i ofron nxënësve dhe nxënësve drejtimet për zgjedhjen e një rasti të cilin BE i ofron prej integritimeve europiane, për të cilën ata mendojnë që është më e rëndësishme.

Pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset e konkursit kanë për detyrë që vizualisht të paraqesin qëndrimet në atë se çka e bënë Europën “zgjedhje të duhur”, për Serbinë dhe ata. Lustrimet duhet të jenë pozitive, vizualisht tërheqëse dhe origjinale. Çdo punë e artit duhet të ketë shkrim të shkurtër tekstual (një fjali ose një fragment), i cili shpjegon dobinë e zgjedhur nga BE, si dhe arsytet për atë zgjedhje.

Profesorët dhe profesoret lutën që të shkarkojnë Ditarin European përmes internetit <http://europa.rs/files/EU-Dnevnik-2016-2017.pdf>, poashtu do t'iu mundësohet edhe një udhëzim i shkurtër në atë se si të fillojnë diskutimin me nxënësit dhe nxënëset për temën e dhënë, ashtu që të sigurohen se punimet e paraqitura përpunohen saktësisht me temën e konkursit.

Konkursi për vitin kalendarik 2016/2017

## Qëllimet

1. Njoftimin e popullsisë së Serbisë Juglindore, veçanërisht të rinjtë, me procesin e integritit europian dhe bashkimin European në përgjithësi.
2. Ti nxisin të rinjtë që të eksplorojnë (kërkojnë) aspektet pozitive, poashtu edhe rastet e rëndësishme të cilat integrimet europiane i oforjnë
3. Frymëzimin (Inspirimi) e dialogut në mes të të rinjve, profesorit dhe profesoreshës dhe shoqërisë civile
4. Avancimin e kushteve të punës në shkollë e cila arrit suksesin më të mirë në konkurs
5. Nxitjen e nxënësve të shkollave të mesme që të shprehin talentin e tyre artistik

## Tema

„Europa: Zgjedhja e duhur“ para pjesmarrësve dhe pjesmarrëseve do të sfidoj që te informohen më mirë ne lidhje me bashkimin European, procesin e anëtarësimit të Serbisë, si edhe të gjitha aspektet e këtij procesi të cilët kanë ndikim direkt në ta. Në këtë mënyrë, rinia do të mund ti njoftoj mundësitë të cilat bashkimi European ia ofron – qoftë ajo në lëminë e arsimit, udhëtimit apo të ngjajshme.

## Formati i shprehur

Punimet e paraqitura mund të jenë në formë të lustrimeve, vizatimeve, fotografive ose kolazhit, dhe nuk duhet të jenë më të mëdha se sa formati A3 (42 x 29,7 cm).

Çdo vepër arti duhet të ketë sqarim të shkurtër tekstual të përfitimit të zgjedhur të bashkimit European dhe arsyet për atë zgjedhje. Sqarimet duhet të jenë të shkruara mirë dhe do të mirren parasysh në vlersimin e punimeve. Ato mund të jenë të shtypura ose të shkruara me dorë mbrapa punimit ose të dorëzohen në fletë të veçantë ose, në disa raste mund të integrohen në vetë veprën e artit.

## Të drejtë pjesmarrje

Nxënës nga të gjitha shkollat e mesme, pa marr parasysh paralelen, nga 34 komuna të përfshira në programin e PROGRES-it European kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs:

- Novi Pazari, Ivanjica, Nova Varosh, Priboij, Prijepolja, Rashka, Sjenica dhe Tutini, në jugperëndim të Serbisë

Programi financohet nga Bashkimi European, Qeveritë e Zvicrës dhe Serbisë dhe do të implementohet nga UNOPS në bashkëpunim me 34 (tridhjet e katër) vetëqeverisje lokale në Jug Lindje dhe Jug Perëndim të Serbisë

Konkursi për vitin kalendarik 2016/2017

- Prokuplja, Blace, Zhitovagja, Kurshumlija në rrethin e Toplicës
- Leskoci, Bojniki, Vllasina, Lebani, Medvegja dhe Crna Trava në rrethin qarkun e Jabllanicës
- Vranje, Bosilegrad, Bujanovac, Vladičin Han, Preševo, Surdulica dhe Trgovishta në rrethin e Pčinjës
- Brus në rrethin e Rasinjës
- Aleksinca, Gaxh Han, Doljevci, Meroshina dhe Svrljigu në rrethin e Nishit
- Babushnica dhe Bela Palanka në rrethin e Pirotit
- Knjazhevcit në rrethin e Zajeçarit.

Në rastë se në ndonjë komunë nuk ka shkollë të mesme, juria do të marrë parasysh aplikimin e nxënësve individual të cilët vijnë nga ato komuna por vijojnë shkollën e mesme jashtë zonës së përfshirë nga PROGRES-i European. Ata nxënës duhet të paraqesin-tregojnë, dëshminë e vendbanimit (fotkopjen e letërnjoftimit, pasaportës ose ndonjë dokument tjetër i cili përmban adresën e përhershme).

#### Obligimet e shkollave të cilat marrin pjesë në konkurs

- Shkollat e mesme që vendosin të marrin pjesë në konkurs për kalendarë duhet të organizojnë konkurs të mbrendshëm të hapur për të gjithë nxënësit
- Çdo shkollë e mesme e cila organizon konkurs duhet të formojë jurinë e shkollës e cila do të bëjë përzgjedhjen e **pesë punimeve më të mira**
- Vetëm një punim për një nxënës mund të dorëzohet për konkurs PROGRES-it European
- Punimet e përzgjedhura të artit ( më së shumti pesë punime për çdo shkollë) duhet të dorëzohen (me postë ose personalisht) në zyrat e PROGRES-it European:

UNOPS/Evropski PROGRES

Naznaka „Likovni konkurs”

Šumatovačka 59

11000 Beograd

- Aty ku nuk ka proces të seleksionimit në shkollë, pjesëmarrësit e interesuar duhet që personalisht ti dërgojnë punimet e tyre.
- **Afati për dorëzimin** e punimeve është **15.nëntorë** deri në ora 12:00.

#### Procesi i përzgjedhjes

- Komisioni për përzgjedhje do të përbëhet prej pesë anëtarëve: dy anëtarë me përvojë të pranuar artistike, një përfaqësues i të rinjve dhe dy përfaqësues të Programit.
- Komisioni përzgjedhës me zgjedhje të ngushtë do të klasifikojë 12 prej të gjitha punimeve të paraqitura
- Komisioni përzgjedhës prej 12 punimeve të cilat kanë hyrë në përzgjedhjen e ngushtë do të shpallë punimet të cilat do të marrin vendin e tretë, dytë dhe të parë.

Programi financohet nga Bashkimi European, Qeveritë e Zvicrës dhe Serbisë dhe do të implementohet nga UNOPS në bashkëpunim me 34 (tridhjet e katër) vetëqeverisje lokale në Jug Lindje dhe Jug Perëndim të Serbisë

Konkursi për vitin kalendarik 2016/2017

- Të gjitha 12 punimet do të shtypen në kalendarin e PROGRES-it European për vitin 2017.
- Komisioni do të shpallë shkollën më të mirë

### Rregullat e përgjithshme të konkursit

- Pjesmarrja në konkurs është pa pagesë
- Punimet të cilat nuk e respektojnë temën apo kërkesat teknike/autoriale do të diskualifikohen
- Në përzgjedhje mund të hyjnë vetëm punimet të cilat nuk janë botuar (publikuar)
- Çdo punim i dorëzuar mbrapa duhet të ketë informatat e mëposhtme:
  - emri dhe adresa e shkollës
  - emri dhe mbiemri i plotë i nxënësit / nxënëses
  - emri dhe mbiemri i plotë i profesorit i cili vëzhgon punën
  - Sqarimin e rastit të zgjedhur të cilën BE mundëson dhe arsyen për atë përzgjedhje.
- Punimet që përmbajnë përmbajtje të pa hijshme mund të diskualifikohen
- Autorët dhe shkollat duhet të garantojnë se asnjë element i punimeve të artit të paraqitura nuk përfaqësojnë kopjen e punimeve tjera origjinale
- Të gjitha fotografitë të përdorura në punimet e artit duhet të jenë në përputhshmëri me ligjin ekzistues të së drejtës autoriale dhe fisnore të Republikës së Serbisë
- Në princip, punët e artit mund t'iu kthehen pjesmarrësve në konkurs pas pranimit të kërkesës me shkrim të dërguar më së voni deri më **15.janar 2017**.
- Autorët mbajnë të drejtën e autorit mbi punimet e tyre dhe mund ti shfrytëzojnë në profilet e tyre të shtypura dhe portalet online (në linjë), në ekspozetë, në librat dhe publikimet, dhe ti dërgojnë (duke përfshirë edhe shitjen) klientëve të interesuar pas përfundimit të konkursit për kalendar të PROGRES-it European për vitin 2017, në dhjetor 2016.
- Me pjesëmarrjen në këtë konkurs autorët dhe shkollat janë të pajtimit që PROGRES-i European, Delegacioni i unionit European në Republikën e Serbisë (DUE) dhe zyra Zvicëranë për bashkëpunim (SDC) në Serbi poashtu mund ti shfrytëzojnë punët e artit me qëllim të promovimit të tyre, publicitetit, lajmeve, trajnimeve informative ose rritjen e vetëdijes
- Emrat e 12 autorëve për punët e tyre më të mira do të gjinden në kalendarin e PROGRES-it European për vitin 2017.
- PROGRES-i European nuk do të bartë shpenzimet e punimit dhe paraqitjen e punimeve të artit.

### Shpërblimet për nxënësit dhe mësuesit

Për 12 punimet më të mira do të shpërndahen këto shpërblime:

- Shpërblimi i parë- Laptop
- Shpërblimi i parë dhe i dytë – Kompjuter tabletë
- Nëntë dhurata ngushëlluese – telefona mobil

Konkursi për vitin kalendarik 2016/2017

- Profesorëve për 3 nxënësit punimet e të cilëve vlersohen më të mira do ti dorëzohen libra

### **Shpërblimi për shkollën fituese**

Komisioni përzgjedhës poashtu do të shqyrtojë angazhimin e organizimit intern të konkursit shkollor.

Një shkollë e mesme do të marrë shpërblim të posaçëm për organizimin e procesit të mbrendshëm selektiv, numri i përgjithshëm dhe kualiteti i punimeve të dorëzuar si dhe prezentimin final të procesit, selektimin dhe dorëzimin e punimeve në konkurs për kalendarin e PROGRES-it European për vitin 2016/2017

Shkolla fituese do të marrë kompjuter laptop, projektor dhe paisjen përcjellëse çka do të duhej të kontribuoj në përmirësimin e kushteve për arsimin e nxënësve.

### **Ceremonia e dorëzimit të shpërblimeve**

Progresi European do të organizojë ceremoninë e dorëzimit të shpërblimeve në pjesën e dytë të dhjetorit 2016 viti. Në kuadër të manifestimit do të organizohet ekspozita e punimeve më të mira të zgjedhura dhe do të prezentohet kalendari i PROGRES-it European për vitin 2017. Nxënësve dhe profesorëve nga vendet e largëta do ti organizohet transport, por shpenzimet rrugore individuale nuk do të kompenzohen.